

---

---

## DOKUMENTE E MATERIALE

---

---

### Dokumente të panjohura të arkivave britanike për Ali Pashën

#### SYNIMET POLITIKE TË BRITANISË SË MADHE NDAJ ALI PASHËS. MISIONET DHE DOKUMENTET E PANJOHURA TË WILLIAM MARTIN LEAKE

##### Zhvillimet politiko-ushtarake në Europë më 1800

Në maj të vitit 1803 ishte rikthyer përfundimisht armiqësia tradicionale mes dy fuqive me të mëdha evropiane, Francës dhe Britanisë së Madhe. Konfliktet e pritshme, të egra dhe të përgjakshme mes tyre dukej qartë se tanimë ishin “në prag të derës”. Marrëveshja e njohur e Paqes, e Amiensit, e vitit 1802 mes tyre, e cila i kishte lënë edhe më shumë të pakënaqur të dy palët, ishte flakur në koshin e plehrave, duke shuar “de fakto” juridikisht dhe politikisht efektet e saj.

Në situatat e një kërcënimi serioz ushtarak, britanikët kishin krijuar një Koalicion të ri për të ndaluar me forcën e armëve revanshin dhe pushtimet e Bonapartit. Por, gjenerali i ri dhe kurajoz francez, pa pyetur për asnjë pengesë, marshonte nën ritmet e trompetave të tij të luftës për të realizuar planet e tij kontinentale. Dhe pa kaluar asnjë vit, në maj 1804, ai shpalli Francën Perandori dhe veten Perandor.

Pikërisht, në këtë kohë, Napoleoni fokusoi ëndrrat dhe planet e pushtimeve të tij mbi territoret evropiane, përfshi ato ballkanike dhe bashkë me to territoret joshëse të Pashallëkut të Janinës.

##### “Udhëtarët e parë” francezë me mision të fshehtë ushtarak në pashallëkun e Janinës

Duke pasur në planet e tij të afërta, veç pushtimeve të territoreve evropiane edhe ato ballkanase, shtabet franceze të luftës e dinin fare mirë se në brigjet perëndimore të Gadishullit Ballkanik ishte konsoliduar tanimë një fuqi e konsiderueshme politike në rritje, nën hegjemoninë e Pashait tepelenas, Ali Pashës.

Por, për të njohur nga afër realitetet ballkanase, specialistët ushtarakë, që njihnin fare mirë parimet dhe kërkesat e artit të luftimeve, përgatitën dhe dërguan me mision të fshehtë në ato anë njerëzit e tyre të kualifikuar të luftës. Qenë dy njerëz, të cilët do të vinin dhe qarkullonin si “vizitorë”, të “interesuar për tregti”, xhaxha e nip – Dhimo dhe Nikolla Stefanopulos. Dy shtetas

francezë me origjinë greke, të cilët njihnin fare mirë gjuhën vendase, zakonet, moralin dhe traditat e tyre<sup>1</sup>.

Të dy misionarët francezë mbërritën në territoret e pashallëkut dhe qëndruan për rreth nëntë muaj, për të zgjidhur një numër detyrash të ngarkuara nga shtabet ushtarake franceze. Ata takuan shumë njerëz, të të gjitha shtresave, përkatësive fetare, politike etj., folën gjatë e për shumë çështje me ta, vizituan dhe shkelën në mjaft territore malore, fushore, bregdetare, rrugë kryesore të rëndësishme strategjike, apo aksesore dhe pa qarkullim.

Në përfundim, xhaxha e nip Stefanopulos, i ofruan shtabeve të interesuara të luftës një informacion të bollshëm dhe të detajuar për gjendjen dhe realitetet e pashallëkut të Janinës. Më pas, këtë material interesat të grumbulluar, të dy misionarët e botuan në përmbledhjen me kujtime udhëtimi nën titullin “Kujtime udhëtimi të Dimo e Nikolla Stefanopulos Epir dhe More.....”<sup>2</sup>

Por, synimet franceze për Ballkanin, përgatitjet e tyre ushtarake në bazat e Pargës, Prevezës dhe Butrintit, që ua kishin marrë venecianëve, dërgimi i misionarëve të fshehtë që qarkullonin në këto territore, afrimet e luftanijeve franceze në këto brigje, etj., padyshim nuk kishin kaluar pa tërhequr vëmendjen e fuqisë tjetër rivale, Britanisë së Madhe, e cila nuk mund të toleronte ndërmarje ushtarake “aty ku prekeshin interesat e saj strategjike...!!!”

### **Reagimi britanik ndaj synimeve dhe përgatitjeve franceze për invazion**

Pikërisht, për këto rrethana tepër interesante, gjejmë në Arkivat Britanike materialet e para të shkruara të Shtabit të Luftës të qeverisë britanike, i cili pasi ka ndjekur me kujdes tërë zhvillimet, lëvizjet dhe përgatitjet franceze për një zbarkim dhe invazion të mundshëm në brigjet perëndimore të Ballkanit dhe konkretisht në territoret e Pashallëkut të Janinës, ka reaguar duke marrë kundërmasat emergjente.

Në Arkivin Hardfordshire-Britaninë e Madhe, ruhet një fond i tërë i veçantë për veprimet e ndërmarra asokohe nga qeveria britanike, shtabet ushtarake dhe misionarët ushtarakë të saj, nëpër territoret e Pashallëkut të Janinës dhe personalisht me Ali Pashën.

Përmes tyre duket qartë se hap i parë i qeverisë britanike ishte dërgimi i njerëzve të saj në territoret që synoheshin për t’u pushtuar nga ushtritë franceze, për të zgjidhur një sërë detyrash delikate dhe reaguar ushtarakisht në rastin e një agresioni të tillë në aleancë me Pashain vendas.

<sup>1</sup> Nicolo Dimo Stefanopulos, *Voyage de Dimo et Nicola Stefanopulos en Grece pendant les annees 1797 et 1798*, Vol. I-II, Prytane, Londres: 1800.

<sup>2</sup> Po aty.

Dokumenti i fillimit të këtij fondi është një “Vendim” me detyra konkrete, që qeveria britanike ka hartuar për misionin që duhet të zgjidhnin ushtarakët e saj ato kohë delikate dhe të rrezikshme. Pikërisht, këtë dokument dhe vendim interesant të qeverisë britanike, që ruhet në këtë Arkiv, (Hardfordshire) po e paraqesim të përkthyer më poshtë.

*Qeveria Britanike,  
Downing Street 28 gusht 1804*

Zotëri,

*Qeveria Britanike, duke e konsideruar si objekt të një rëndësie të veçantë mbrojtjen e kufirit grek (në varësi të Perandorisë Osmane) ndaj kërcënimit të sulmeve franceze, ka gjykuar si të arsyeshëm dërgimin me mision ushtarak në ato anë të një oficeri nga radhët e Artilerisë Mbretërore. Meqë, Madhëria e tij pati kënaqësinë t’ju për zgjidhte ju, (Është fjala për Kapitenin e Artilerisë Mbretërore, W. M. Leak – shënimi ynë I. Koçollari) mendoj se është e nevojshme t’ju japë udhëzimet e mëposhtme, me qëllim që të mund të organizoni punët dhe detyrat tuaja.*

**Së pari**, duhet të njiheni me brigjet perëndimore të Shqipërisë dhe Moresë dhe në mënyrë të veçantë me ato pika, të cilat për nga afërsia me brigjet italiane, jo vetëm që janë të ekspozuara në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj sulmeve të armikut, por gjithashtu paraqesin me tepër lehtësi nga pikëpamja e zbarkimit.

**Së dyti**, nëse mendoni që komandantët turq të atyre anëve i përmbushin kushtet si dhe kanë mundësitë dhe mjetet të zbatojnë dhe përmbushin urdhrat, do t’i sugjeroni atyre ndonjë masë përmirësimi për mbrojtjen e atyre vendeve.

**Së treti**, do të shoqëroheni dhe do të mbështeteni në ndihmën që do t’ju ofrojnë topografët dhe skicografët e Ushtrisë Mbretërore. Në rast se kjo nuk do të mund të realizohet, jeni i autorizuar të punësoni persona të tjerë. Ju do të ndërmerrni inspektime dhe do të përpiloni skica, duke u munduar që një veprim i tillë mos ngjallë xhelozë dhe pakënaqësi tek banorët e vendit. Për t’ju lehtësuar punën, Ministri i Madhërisë së tij pranë Portës së Lartë do t’ju ndihmojë të pajiseni me fermanët e nevojshëm.

**Së katërti**, do të vizitoni të gjitha fortifikimet përgjatë bregdetit me qëllim që të shikoni gjendjen e tyre si dhe të verifikoni nëse i plotësojnë kushtet për të shfaqur rezistencë. Nëse kërkesat e tyre mund të plotësohen lehtësisht, së bashku me Z. Morier, ju mund të përpiqeni të nxisni Guvernatorët e Turqisë, që, për sa është në fuqinë e tyre, të marrin masat e nevojshme teknike për të zëvendësuar ato në pikat më të rëndësishme. Këtë informacion do t’ia përcillni Ministrin të Madhërisë së tij pranë Portës së Lartë, dhe nëse ai e shikon të arsyeshme, mund t’ju mbështesë në këtë ndërmarrje.

**Së pesti,** pasi të keni siguruar informacionin e nevojshëm për vijën bregdetare, ju do të vazhdoni për më në brendësi të vendit, me qëllim që të përfitoni një panoramë të përgjithshme të vendit. Kjo mund të jetë e domosdoshme për suksesin e veprimeve ushtarake, në rast se armiku ndërmerr një zbarkim nga bregdeti. Për t'i kthyer këto vëzhgime në një pasuri të përhershme (duke u këshilluar në mënyrë të veçantë më topografët që do të shoqërojnë) duhet të mbani shënim rrugët dhe kalimet tokësore që në njerën anë të çojnë në Kostandinopojë dhe në anën tjetër drejt Moresë. Të observosh pengesat që mund të ndeshë një pushtues drejt avancimit për në vendet e tjera dhe mënyrat e efektshme për ti kapërcyer këto pengesa.

**Së gjashti,** do të kontaktoni me Ali Pashën, apo Bejlerbeun e Rumelisë, dhe do t'i ofroni atij këshillat dhe opinionet tuaja në lidhje me një plan të përgjithshëm që ka të bëjë me mbrojtjen e territoreve të tyre, me shpërndarjen e trupave dhe mënyrën më të mirë për t'i arritur me një nivel të konsiderueshëm të ardhurat nga limanet e portet. Do të mbështesni dhe do të plotësoni kërkesat e tyre, brenda mundësive tuaja, për sa i përket organizimit paraprak dhe përmirësimit të artilerisë. Në përgjithësi, do të këshilloheni me ta për të gjitha ato çështje ushtarake që kanë të bëjnë me sigurinë e tyre ndaj synimeve armiqësore të francezeve.

**Së shtati,** pasi të keni përbushur misionin tuaj tuaj në Greqinë Veriore, do të vazhdoni drejt Korinthit, për t'u njohur me mungesat e atij porti të rëndësishëm dhe tepër të vështirë, me qëllim që t'i plotësojnë sa më shpejt që të jetë e mundur ato. Do të bindni komandantët turq që të vendosin një garnizon të aftë në këtë fortesë për të siguruar kalimet e vështira që të çojnë tek ajo, nga drejtimi i Veriut, dhe së fundi për të ngritur një kamp të rrethuar me llogore, në Isthmos.

**Së teti,** do të vizitoni të gjitha pikat e tjera strategjike, në afërsi të Moresë dhe në veçanti ndërtimet fortifikuese të venecianëve, për të njëjtat qëllime, si ato të specifikuar në pikat paraardhëse, për sa i përket Korinthit dhe vendeve përgjatë bregdetit.

**Së nënti,** gjatë udhëtimit ju do të vëzhgoni dhe do të raportoni prirjet politike dhe ushtarake të banorëve.

**Së dhjeti,** në ndjekje të të njëjtit synim do t'i kushtoni vëmendje të veçantë gjeografisë së përgjithshme të Greqisë, me qëllim që të siguroni për Qeverinë dhe kombin Anglez të dhëna më të sakta sesa ato që kemi në dispozicion deri më tani për këtë vend interesant, por ky duhet të jetë dytësor në lidhje me qëllimin kryesor të misionit tuaj, të cilit duhet ti kushtohet vëmendje parësore.

**Së njëmbëdhjeti,** në rast se armiku, aktualisht, realizon një zbarkim në Greqi e nëse trupat ruse në Korfuz ndërmarrin veprime më aktive për të arritur synimet e tyre ndaj Turqisë Evropiane, ju do t'i ofroni gjeneralëve rusë mbështetjen dhe ndihmën tuaj, për sa i përket njohurive që keni në lidhje me

vendin, gjithashtu do të përpiqeni të ruani një influencë personale me Kryekomandantin e forcave turke, veçanërisht do ta përdorni këtë influencë për t'i bindur ata që të tregojnë kujdes në ruajtjen e furnizimeve dhe pasurive të çdo lloji.

*Se dymbëdhjeti, ju do të korrespondoni me Z. Arthur..., Z. Morier dhe Z. Foresti në lidhje me ato çështje që mund të jenë të rëndësishme për informacionet e tyre; në mundësinë me të parë do t'i raportoni përfundimet e vëzhgimeve tuaja tek Z. Aleksanser Bull, Lord Nelson si dhe tek ajo zyrë.*

*Kapitenit Lik,  
Artileria Mbretërore<sup>3</sup>*

Pa dashur të bëjmë komente të gjata për përmbajtjen e këtij dokumenti, i cili është i qartë dhe i kuptueshëm në mesazhin e tij, do të nënvizonim vetëm faktin se përmes tij shihet qartë shqetësimi i qeverisë britanike për rrezikun eminent që paraqisnin trupat franceze për zbarkim dhe invazionin e mundshëm mbi territoret e Pashallëkut të Janinës e më gjerë, zona të cilat ajo i konsideron “me interes strategjik të veçantë për vetë Britaninë”.

Ndërsa në pikën gjashtë të kësaj korrespondence ne gjejmë detyrat konkrete, që duhet të zgjidhnin misionarët britanikë, me dhe përmes Ali Pashës. Në të flitet hapur dhe qartë se anglezët duhet t'i tregojnë Aliut për rrezikun e një zbarkimi dhe pushtimi ushtarak të territoreve të tij, nga ushtritë franceze. Dhe, siç do të shohim në vazhdim këtë gjë anglezët e kanë bërë. Ata jo vetëm i kanë treguar atij qëllimet ekspansioniste të francezëve, por në kuadrin e prevenimit të një pushtimi të mundshëm ata i kanë dhënë këshilla dhe orientime me karakter ushtarak, i kanë dhënë armatim, artileri dhe gjer anije lufte, inventari dhe lista e të cilave ruhet ende, bashkë me dokumentet e tjera në këtë arkiv.<sup>4</sup>

Dhe çuditërisht për kryerjen e këtij misioni të vështirë dhe realizimin e tërë këtyre detyrave që parashtrihen në vendimin e qeverisë britanike, aso kohe ishte ngarkuar një djalosh i ri, që nuk i kishte mbushur të njëzet e shtatë dhe mbi supë mbante gradën e Kapitenit të Artilerisë Mbretërore Britanike. Ai quhej William Martin Leak.

#### **Urdhëri i admiralit Nelson që rekomandon ndihmën për misionin e Kapitenit Leake**

Dhe me të marrë detyrën e ngarkuar nga qeveria britanike, një ditë tetori, djaloshi i ri, 27 vjeçar, W. M. Lik, do të nisej nga limani i Portsmuthit për në drejtim të brigjeve të Shqipërisë. Në radhën e dokumenteve të Arkivit të

<sup>3</sup> Arch. Hardfordshire–London, GB – Foreign Office (më tej: F.O.) etj. 85492 , dt. 28. 8. 1804, f. 181.

<sup>4</sup> Po aty, F.O. 76348. Shih. Listat të armatimit të artil, predhave, kalibrit, brika, etj.).

Hardfordit gjendet edhe urdhri i Admiralit të njohur të Flotës Mbretërore Britanike, Nelson, i cili urdhëron sa më poshtë:

Të gjithë Kapitenëve dhe Komandantëve  
Të çdo anijeje lufte apo tregtare të Mbretërisë Britanike  
Të angazhuar në Adriatik

Në luftanijen “Victory”, më 4 Tetor 1804

Zotëri!

Meqë Kapiteni i Artilerisë Mbretërore, Lik, është komanduar nga qeveria britanike të udhëtojë drejt Korfuzit, dhe mandej në bazë të instruksioneve, i lipset të gjejë mënyrën për të ruadur në drejtim të Moresë ose Shqipërisë.

Nisur nga sa sipër lëshoj për ju këtë urdhër të posaçëm që:

Të gjitha Anijet e Madhërisë së tij apo transportierët, që janë nën komandën tuaj dhe ndodhen në afërsi apo kanë për destinacion vendet e lartpërmendura, – nëse nga ana e Kapitenit Lik parashtrahet Kërkesa e nevojshme për të udhëtuar me anijet tuaja,

Ju, me tu njohur me Kërkesën duhet të viheni menjëherë në dispozicion të realizimit të shërbimit të tij tepër të rëndësishëm dhe ai vetë të pajtohet më mënyrën tuaj të vepruarit.

Unë jam Shërbëtori Juaj i Përvullur dhe i Bindur  
Sër Nelson Bonte<sup>5</sup>

### **Kush ishte kapiteni i ri 27 vjeçar i ngarkuar për realizimin e misionit pranë Ali Pashës?**

Duket e çuditshme, gati paradoksale, por është e vërtetë, që W. M. Leak, një studiues i talentuar, një historian i mirëfilltë, që njihet në rrethet shkencore dhe ato albanologjike, për gati 200 vjet me radhë, si një kontribues i parë, nismëtar i Albanologjisë dhe studimeve të mirëfillta shkencore, në thelb ka mbërritur në territoret shqiptare dhe ka filluar punën e tij si një ushtarak zbulimi, i ngarkuar me misione të rëndësishme politiko-ushtarake nga qeveria e tij.

Lindi në janar të vitit 1777, në Londër. Ishte i biri i Xhon Martin Lik-ut, nip i Stefan Martin Likut, edhe ky një burrë me emër që kishte kaluar tërë jetën si ushtarak. Ndërsa i ati i Williamit, Xhoni, pati shërbyer në Flotën Ushtarake të Mbretëreshës Ana.

<sup>5</sup> Po aty, FO 85 494, 4.8.1804, f 13.

Mbasi mbaroi studimet në Akademinë Mbretërore, më 1794, W. M. Liku, mori emërimin dhe filloi karrierën e tij ushtarake si oficer i Artilerisë Mbretërore. U caktua me shërbim në frontin e West Indies. Mbas gati pesë vitesh, më 1799, transferohet prej këtu dhe caktohet instruktor artilerie në Kostandinopojë, por brenda vitit, më 1800 detyrohet të braktisë kryeqytetin e Perandorisë Osmane për të kryer të tjera misione të rëndësishme.

Po këtë vit, merr titullin Ambasador i Mbretërisë dhe ngarkohet me mision special ushtarak pranë Vezirit të Madh, që aso kohe ishte në luftë me Francën, detyrë që gjer atëherë e kishte kryer në Azinë e Vogël, Keller. Mbas disa muajsh, ndërsa anulohet Traktati i Qipros, edhe Liku për pasojë ndërpret detyrën e marrë dhe shkon me mision të ri në Siri, Palestinë dhe Jude (Izrael) pranë Vezirit Osman, që administronte këto pjesë të Perandorisë.

Në vitin 1801, ishte prezent në ngjarjet që ndoqën fushatën e Egjiptit, ndërsa më 1802 rikthehet përsëri në Siri, duke kryer krahas misionit të tij ushtarak edhe kërkime me karakter shkencor. Punët dhe studimet e tij nëpër territoret e këtij vendi ai i shtriu gjer në brigjet e Egjiptit, duke evidentuar, seleksionuar dhe mbledhur objekte dhe vepra arti të antikitetit në mermer. Tërë inventarin e pasur të këtij materiali arkeologjik, Liku e imbarkoi në anijet britanike të luftës dhe prej këtu i çoi në Britani, tek Lordi Elgin.<sup>6</sup>

Në fund të vitit 1802, ai u kthye në Angli për t'u larguar përsëri pas dy vjetësh, në një tjetër terren të largët nga brigjet ishullore britanike.

Në vitin 1804, Kapiteni i ri 27 vjeçar, ngarkohet me një mision të ri, mision i cili, siç do të shohim më pas, ndikoi thellësisht në karrierën, ecurinë, fatet dhe pse jo në tërë jetën e këtij djaloshi të talentuar. Tanimë detyra e ngarkuar nga qeveria britanike e urdhëronte Likun të nisej brenda territoreve jugore të Evropës, në një anë pothuaj të harruar, të panjohur të kontinentit plak, Ballkanin Perëndimor. Kështu, në vitin 1804, Kapiteni i ri i Artilerisë Mbretërore, nisej me mision zbulimi ushtarak, në territoret e Pashallëkut të Janinës, për të qëndruar gjer në dimrin e vitit 1806.

### **Misioni drejt Pashallëkut të Janinës**

Por si do ta realizonte Kapiteni i ri misionin e ngarkuar?

Si çdo operacion zbulimi edhe në kohët moderne, misionarët e ngarkuar, e fillojnë punën mbështetur në dy mënyra, për njohjen e terreneve ku do të shkojnë:

–... duke lexuar përpara nisjes çdo shënim apo studim të pararendësve, dokumente të udhëtarëve, të misionarëve, topografëve, piktorëve, gazetarëve, aventurierëve dhe spiunëve... dhe ...duke shkelur me këmbët e tij tërë terrenet

---

<sup>6</sup> The biography of W. M. Leake; British Royal Navy – Arch. Arch. Hardfordshire – London, GB – F. O. Ext.

ku pritet apo mendohet të zbresë apo pozicionohet kundërshtari, duke vëzhguar me kujdes, duke mbajtur shënime, duke u futur në mes të njerëzve, për të mësuar bindjet, prirjet, tendencat, formimin, moralin, kulturën, etj.

Duke qyrrur me kujdes tërë informacionet e përgatitura dhe të shkruara, nga dora e Kapitenit Lik, për eprorët e tij ushtarakë, për Ministrinë e Mbrojtjes, duket qartë se Liku e ka nisur rrugën e tij të vështirë, për në drejtim të territoreve shqiptare atëherë kur të dhënat dhe informacionet për këto vende dhe popullsi ishin pothuaj inekzistente.

Duke qenë një njeri me një kulturë të gjerë, jo vetëm profesionale ushtarake dhe politike, por edhe me një pasion të veçantë për historinë, përpara marrjes së detyrës dhe zbritjes në brigjet ballkanike, ai kishte lexuar me një etje dhe përqendrim të veçantë historinë e lashtë të këtyre anëve dhe popujve të Ballkanit, kishte shfletuar dhe njihte përmendësh autorët antikë grekë dhe romakë, përplasjet ushtarake, aleancat, qytetet antikë, rrugëkalimet e vjetra, vendvendosjet e ushtrive kundërshtare, etj.

Ndërsa zbriste në brigjet shqiptare, megjithëse vetëm 27 vjeçar, Liku njihte me një saktësi të çuditshme burimet dhe autorët antikë, të cilët kishin shkruar rreth Ilirisë. Ai kujtonte dhe citonte me korrektësi emrat e fiseve ilire, kufijtë e shtrirjes së tyre, vendet ku qenë zhvilluar betejat, rrugët e njohura dhe të panjohura të kalimit të ushtrive të huaja, vend dislokimet e legjioneve romake, forcave maqedonase, konsujt dhe gjeneralët romakë Sulspicius dhe Paulus Emilius, vendqëndrimet dhe fortifikimet e ngritura nga Cezari përballë Pompeut, qytetet bregdetare ku zbritën Mark Antoni, etj.

Por, tanimë ai qytetërim që shuar, mjaft qytete, dikur tërë shkëlqim dhe hijerëndë qenë rrafshuar nga themelet dhe mbuluar nga hiri i zjarreve dhe i harresës njerëzore. Por, për syrin e Likut nuk ishte e vështirë që ato të identifikoheshin, sepse kishin mbetur në këto horizonte gjeografike lumenjtë dhe malet, Apsusi, Genesusi, Aosi, Tomari, qytetet e njohur Dyrrahu, Lissusi, Buthroti, Skodra, etj. Duke njohur të gjitha këto, me një intuitë të admirueshme, ai identifikon vendbanimet e dikurshme, fortifikimet, faltoret dhe tempujt, që flinin nën heshtjen shekullore, nën tokën shqiptare.<sup>7</sup>

Me gjurmimet identifikuese historike, me analizat dhe konkluzionet e tij shkencore, Liku renditet kështu ndër historianët apo arkeologët e parë, të vendin tonë, e pse jo, njeriu që deklaroi dhe argumentoi aso kohe, mendimin ende të panjohur, të vazhdimësisë iliro-shqiptare. Ai ofroi argumente mbi origjinën e racës shqiptare, parashtrroi evidenca rreth traditave dhe etnografisë, botoi studime rreth nomizmatikës, gjuhës shqipe etj. Në këtë mënyrë Liku u paraprin, pa mëdyshje, plejadës së albanologëve, që pasuan në gjysmën e dytë

---

<sup>7</sup> William Martin Leake, 1830; "Travels in Morea", 1-3 Vol, Londra, 1830; dhe "Travel in Northern Greece", vol. I-II-III-IV, Londra, 1835.

të shekullit XIX, në Evropë si Hahn, Shuflai, Prashniker, Pach, Finlay, Fallmerajer, Jokli, etj.

### **Një punë e dyfishtë - ushtarak dhe historian**

Padyshim, detyra e Likut ishte ajo e misionarit, zbuluesit ushtarak, pra mbledhja e informacioneve të atyre fushave, që i kishte caktuar Shtabi i Luftës britanik. Janë disa qindra faqe informacion, të shkruara me një rregullsi të admirueshme, nga dora e Kapitenit dhe më pas Kolonelit W. M. Lik. Te gjithë ky dokumentacion, dallon qartë një punë këmbëngulëse dhe voluminoze, të një profesionisti të talentuar, të fushave të shërbimit të luftës.

Ai ka udhëtuar pa u lodhur, ka vëzhguar dhe fokusuar tërë objektet e nevojshme për informacionet e tij, ka takuar dhe bashkëbiseduar me njerëz të rajoneve e shtresave të ndryshme, të popullsisë shqiptare e greke, çamë, toskë, lebër, vllahë, funksionarë të administratës osmane – pashallarë, bejlerë, vezirë, spahinj, ushtarakë të karrierës, etj; ka bërë teste e matje, ka zgjedhur dhe ndërruar burimet e informacionit, mandej ka hedhur në letër gjithçka me objektivitet dhe realizëm të pabesueshëm.

Informacionet “sekrete”, të panjohura të Kolonelit Lik, të përgatitura dhe dërguara për shtabet e tij ushtarake, të pashfletuara dhe të paeksponuara gjer tani, po të studiohen edhe sot, ato ruajnë vlera të vërteta, jo vetëm në pikëpamje skematike por edhe në brendinë e tyre për çështjet sociale, religjioze, ekonomike, që ato trajtojnë.

Vëllimi i madh i këtij dokumentacioni, tregon përqendrimin dhe punën e palodhur të këtij zbuluesi informator të talentuar dhe po të marrim parasysht mjetet me të cilat qarkullohej aso kohe, për grumbullimin e informacionit, instrumentat për transmetimin e tij, vështirësitë e jashtëzakonshme të lëvizjes, të kushteve ekonomike, të transportit, pasigurinë e terrenit, mund të kuptojmë se me çfarë vështirësi dhe pengesa është dashur të përballej ky oficer i ri.

Megjithatë, duhet thënë se edhe në këtë grumbull dokumentesh me tematikë të përcaktuar ushtarake, që Koloneli Lik i ka dërguar shtabeve të luftës, ka mjaft çështje me vlerë dhe interes të veçantë historike dhe shkencore. Ato fillojnë nga momenti që Kapiteni i ri Lik vë këmbën në territoret e Ballkanit dhe vazhdojnë në tërë fletët që procedojnë, gjer në fund të qëndrimit të tij në këto anë me subjekt; topografinë e territoreve, rrugëkalimeve, gjendjen ekonomike të krahinave kontinentale dhe ishullore ballkanase, gjeografinë në tërësi, etj.

Duke i parë këto territore me syrin e një specialisti të fushës së luftës, si dhe specifikat që ato ofrojnë apo pengojnë në rastin e tentativave për agresion të mundshëm, Liku shkruan:

*“...Gjiri i Lepantos (Artës) nga jugu shfaq vështirësi për një ushtri pushtuese, gjë që për mua është i dyshimtë për të mos thënë i pamundur zbarkimi i forcave franceze nga toka me synim pushtimi këtu...”. ”Në*

*këtë Gji nuk është stacionuar asnjë Forcë Navale osmane për të penguar ndonjë zbarkim të mundshëm...të tyre...". "Popullsia që shtrihet nga Actium (Prevezë-shënimi ynë) gjer në Zeitum (Afër Termopileve) është e përbërë nga grekët dhe shqiptarët..."<sup>8</sup>*

Më 30 qershor, të vitit 1804, duke iu referuar gjendjes dhe informimit politik të popullsisë të këtyre anëve, mbas kontakteve të shumta me njerëz të shtresave dhe niveleve të ndryshme, Kapiteni Lik shënon dhe informon qendrën e tij:

*"Popullsia e kësaj zone nuk ka as idenë më të vogël, në lidhje me faktin e synimeve pushtuese apo të një agresioni të mundshëm të francezëve mbi këto territore..."<sup>9</sup>*

Ndërsa duke folur për konceptet e ndarjes së vendeve dhe të kufijve të tyre sipas përbërjes etnike të popullsisë, Morieri shkruan:

*"...Vendi që shtrihet nga Gjiri i Artës dhe shkon larg, drejt veriut, gjer në Bojanë, quhet Shqipëri. Territoret e këtyre anëve paraqesin për pushtuesin një pengesë tepër rezistente natyrore..." "Pashallëqet kryesore të Shqipërisë janë ato të Shkodrës, Janinës dhe të Vlorës. Ky i fundit, nisur nga pozicioni ndërmjet dy të tjerëve është më pak i fuqishëm..."<sup>10</sup>*

Në po këto raporte ushtarake, të dërguara Shtabit ushtarak britanik, në Londër, gjejmë këto analiza dhe konkluzione të rëndësishme historike dhe shkencore, që lidhen me origjinën e popullsisë shqiptare, që banon këto anë:

*"Arnautët – kështu quhen banorët e Shqipërisë, - me zakonet, kostumet dhe sidomos me ndarjen e tyre në fise, tregojnë qartë edhe një herë, lidhjen e tyre me origjinën, si banorë autoktonë të Epirit dhe të Ilirisë. Ne mund të gjejmë tek Suli, emri i zonës malore që banohet nga suljotët, emrin e Sellit, - fisi barbar që përmendet tek Homeri, siç shënon Straboni, për banorët në afërsi të Dodonës. Gjuha e tyre ka pësuar një ndryshim thelbësor. Ata janë të vetmit që nuk flasin greqisht. Ata flasin një dialekt, i cili nuk ekziston i shkruar në karaktere dhe përbëhet nga Ilirishtja, turqizma, greqizma dhe vllahizma..."<sup>11</sup>*

<sup>8</sup> Arch. Hardfordshire – London, GB – F. O. 78/44, f. 84.

<sup>9</sup> Po aty, faqe 86.

<sup>10</sup> Po aty, faqe 89.

<sup>11</sup> Po aty, faqe 96.

Ndoshta ky konstatim shkencor, në këtë raport ushtarak, është nga të parët, për të mos thënë i pari që institucionalisht përcakton origjinën ilire të shqiptarëve, mendim që më pas tërhoqi vëmendjen dhe u mor në konsideratë prej studiuesve dhe albanologëve gjermanë, austriakë, e franceze të mëvonë, si dhe rilindasve tanë, të gjysmës së dytë të shekullit të XIX.

Në një tjetër raport konkludiv, të vitit 1805, pasi Kapiteni Lik kishte udhëtuar nëpër territoret e Pashallëkut të Janinës, për disa muaj, informon eprorët e tij për situatën në Shqipëri si më poshtë:

*“Udhëtimi për në Zalongë më dha mua mundësinë të kqyr mirë vendin rreth Artës dhe Pargës. Në një rast të mëparshëm kisha vizituar krahinat e Konispolit, Delvinës, Gjirokastrës, Tepelenës, dhe Himarës. Në këtë mënyrë, kam mundur të grumbulloj tërë materialin e nevojshëm për përpilimin e Hartës të të gjithë Bregdetit dhe zonës detare, nga Gjiri i Vlorës gjer tek Gjiri i Lepantos.*

*Bashkë me informacionin po ju dërgoj edhe hartën e përpiluar me këtë rast...”<sup>12</sup>*

Por, ajo që na tërheq më tepër vëmendjen, nga ky informacion i Kapitenit Lik, dërguar Londrës, është vlerësimi tepër interesant, që ai i bën Gjirit të Vlorës, duke e përcaktuar atë, nga pikëpamja strategjike, si një nga terrenet më të rëndësishëm ushtarako-detarë për tërë ujërat e deteve të Adriatikut dhe Jonit. Në këtë mënyrë, ne mësojmë se vlera, pozicioni, rëndësia e këtij Gjiri dhe roli që mund të luante ai, nuk ishin zbuluar nga rusët, të cilët ngritën pas Luftës së Dytë Botërore, bazën e rëndësishme ushtarako-detare të Pashalimanit, por shumë përpara tyre, gati 150 vjet më parë, vlera dhe pozicioni i rëndësishëm i Pashalimanit ishin zbuluar edhe përcaktuar si të tilla nga specialistët e artit ushtarak britanik. Në këtë raport, për Gjirin e Vlorës, Kapiteni Lik, shënon:

*“Gjiri i Vlorës është pozicionuar në ...hyrje të Adriatikut... ai është nga më të mirët për të mbajtur një flotë të madhe, pasi është në gjendje të mbajë një numër të madh anijesh...”*

*Flota mund të pozicionohet këtu me një siguri mbrojtëse absolute nga toka dhe malet shkëmborë. Ngushtica midis ishullit të Sazanit dhe Kepit Lingueta e vështirësojnë kalimin për të hyrë në Gji të një kundërshtari ...”<sup>13</sup>*

### **Të vërtetat përtej protokollit dhe dokumenteve të publikuara**

Padyshim, këto informacione, duke qenë të një natyre sekrete, kanë vlerën dhe detyrimin që qeverisë t’i raportohet gjithçka; tërë intimitetet, tërë rengat, që kurdisen prej vetë misionarëve britanikë, të cilët shtiren si miq, tërë shmangiet

<sup>12</sup> Arch. Hardfordshire – London F. O. 78/57, faqe 98, Janinë 22 Gusht 1805.

<sup>13</sup> Po aty, Janinë 22 Gusht 1805, Letër e Likut qendrës.

apo mashtrimet e natyrave politike e diplomatike, tërë ato që janë paraqitur si të vërteta në takimet zyrtare me Ali Pashën dhe lakuriqësia e tyre jashtë protokollit bilateral shtetëror, etj.

Duke qenë raporte konfidenciale, edhe përmes faqeve të raportimeve “sekrete” të Kolonelit Lik, dalin në pah edhe premtimet e pambajtura të britanikëve ndaj Ali Pashës, synimet që i janë mbajtur fshehur Pashait të Janinës, loja dyfishe me tepelenasin dhe lëvizjet dinake, koniukturale dhe për interesa të njëanshme të diplomacisë britanike ndaj Vezirit të Janinës.

Duke njohur këto të fshehta, që kanë bartur dokumentet sekrete, pra duke shfletuar tanimë të vërtetat e panjohura, mund të gjykohen me më shumë realizëm ato pjesë të historisë së shkruara më parë dhe të rishohim apo rivlerësojmë edhe një herë imazhet e personazheve të përbaltur apo deformuar padrejtësisht, nga mungesa dhe heshtja mëkatore e të vërtetës mbyllur nga koha, indiferenca apo qëllimet e mbrapshta.

Duke iu referuar njëres prej tyre, gjejmë dhe mësojmë qartë frikën dhe shqetësimin e përfaqësuesit britanik, Likut, për pozicionet e dyfishta, që kanë mbajtur ndaj tepelenasit, pararendësit e tij.

*“Unë besoj se...Veziri mund të kënaqet nëse ne ndërmarrim disa hapa të vegjël në favor ( të situatës atje ...në Santa Maura) tij ... Unë insisto në këtë sepse në rrethanat e mbizotërimit të një mosbesimi total, është e nevojshme të largojmë nga Aliu çdo hije dyshimi ndaj nesh.*

*Kam arsye të besoj dhe them këtë, sepse Ali Pasha nuk e ka harruar zhgënjimin që përjetoj kur nuk mori asnjë përgjigje në lidhje me disa ndihma dhe favore që ju premtuan nga Qeveria e jonë më 1804, përmes Lordit Nelson...e kam fjalën armët, municione dhe anijet e luftës...që i premtuan...dhe nuk ja dërguam.”<sup>14</sup> (14)*

Me një elokuencë të hollë diplomatike, duket që Ali Pasha, për t’i treguar dhe përcjellë rezervat dhe pakënaqësitë e tij britanikëve, ndaj mashtrimit dhe imoralitetit diplomatik të dikurshëm, të treguar ndaj tij, me një frazë paralajmëruese, i drejtohet Likut me një ironi që duket se ja arrin qëllimit:

*“Unë jam në gjendje të bëj dallimin midis propozimeve tuaja dhe gjuhës së mashtrimit dhe pabesisë me të cilën më flasin vazhdimisht agjentët francezë...”<sup>15</sup>.*

<sup>14</sup> Po aty, Letër e W. M. Likut dërguar Sekretarit të Shtetit për Punët e Jashtme, më 1807.

<sup>15</sup> Po aty.

Në vazhdim të kryerjes së detyrave të ngarkuara nga Londra, Koloneli Lik, duhej t'i përgjigjej shtabeve ushtarake të tij, edhe për dilemën se kush do të ishte pika e mundshme e zbarkimit të forcave franceze, në rastin e një invazioni të mundshëm, në bregdetin e pashallëkut dhe cili do të qe itinerari që do të ndiqnin repartet franceze për të hyrë në thellësi dhe pushtuar tërë Ballkanin.

Duke i vënë tërë lëvizjet e tij, nëpër terrenet e pashallëkut, në funksion të detyrave dhe misionit të ngarkuar, britaniku, pasi ka kqyrur me vëmendje të veçantë dhe përqëndrimin e një specialisti të fushave militare, në një prej informacioneve të tij, të gushtit të vitit 1805, Liku shkruan:

*“Dy pikat e bregdetit nga ku armiku (francezët) mund të depërtojnë në drejtim të Tepelenës janë fusha e Gjirokastrës dhe e Vlorës, si dhe rrafshina e Delvinës, 30 milje larg Tepelenës. Pjesa e rrugës në afërsi të atij vendi, që unë pata mundësinë ta kqyrja dhe observoja me vëmendje është një kalim i rrezikshëm...”*

*“Armikut (francezëve) në rast se do të arrijë të pushtojë këto vende, mund t'i lindë dhe të ushqejë mendime të mbrapshta, si përshembull, të depërtojë në thellësi të vendit, në Maqedoni. Por, për të arritur këtë, ai është i detyruar të përdorë tre vendkalime; 1. Ose fushën e Gjirokastrës, 2. Ose Sulin, 3. Ose drejtimin e Janinës.*

*Në rast se ai përdor dy mundësitë e para, unë kam mendimin se ai do të dështojë, si rezultat i terrenit tepër të vështirë...”<sup>16</sup>*

Ndërsa duke folur për rolin dhe natyrën e popullsisë, që banon këto territore, si dhe rolin që do të mund të luante ajo në rastin e një invazioni apo sulmi të mundshëm francez, koloneli sqaron:

*“Natyra dhe karakteri ushtarak i banorëve të këtyre zonave duket kryesisht tek: - numëri i madh i ushtarakëve që ata kanë në strukturat e pashallëkut, - tek mënyra se si ata luftojnë, - tek prirjet e tyre për të zburar çdo pushtues të huaj, - si dhe tek mjetet që ata përdorin për të realizuar këto ideale...”<sup>17</sup>*

\* \* \*

### **Harta dhe skica të panjohura të terreneve**

Në radhët e këtij dokumentacioni arkivor, që ruhet në arkivat britanike ka edhe një numër të gjerë dhe të detajuar skicash të terreneve bregdetare apo edhe gadishullore, që ilustronjë me përmasa konkrete informacionet periodike që W.

<sup>16</sup> Po aty, Informacion i Kol. Lik dërguar Londrës, nga Janina 22 Gusht 1805.

<sup>17</sup> Po aty.

M. Liku i ka dërguar Londrës. Këtë fakt e gjejmë të shprehur ne vetë informacionet e tij, kur thotë:

*“Këtë hartë, të përpiluar nga ana ime, po jua dërgoj Juve, duke iu kërkuar ndjesë për ndonjë gabim apo pasaktësi, pasi siç e dini unë nuk jam skicograf i mirëfilltë, por që rrethanat më kanë detyruar të bëj punën e tij. Gjithsesi jam i bindur se në shumë detaje ato janë të përpikta dhe të sakta... largësitë ... këndet... gjerësitë gjeografike...”<sup>18</sup>*

Këto dhe shumë informacione të tjera, të përgatitura për eprorët dhe shtabet ushtarake, janë vetëm një pjesë e punës së Likut, ajo pjesë për të cilën e kishte ngarkuar qeveria e tij. E, megjithatë edhe në to, çdo lexues mund të dallojë qartë penën e një njeriu të kulturuar, mendimin e një studiuesi me dije të thella. Liku nuk shfaqet as në këto informacione, megjithëse të natyrës ushtarake, me një gjuhë të varfër nën skematizma hierarkike militare pedante, me vizione të ngushta dhe të mbyllur brenda klisheve ushtarake. Përkundrazi, edhe në këto fashikuj të destinuar për strukturat e luftës, gjen lëndë me një vlerë të madhe historike, arkeologjike, shkencore e studimore. Kjo duket se është sa meritë e traditave të shkollave ushtarake britanike aq dhe e ambicieve dhe pretendimeve personale të këtij të riu të kulturuar. Por, kjo pjesë jo e vogël e punës së Likut, që përmendim më sipër është ende e panjohur.

Themi “pjesë jo e vogël”, sepse siç dihet, nga tërë rrethet shkencore dhe veçmas ato historiografike, W. M. Liku ka një krijimtari tjetër, voluminoze, të njohur, të shpallur dhe të botuar në disa libra. Kjo, pjesë e njohur, është krijimtaria e tij kërkimore, shkencore.

Por, një gjë mund të thuhet me siguri: Liku ka bërë mirë si detyrën dhe misionin e ushtarakut ashtu edhe punën si kërkues dhe hulumtues në fushën e historisë, gjuhësisë, nomizmatikës, arkeologjisë, (natyrisht në ende sot nuk dimë se çfarë relikash historike të artit të antikitetit ka arritur të mbledhë koloneli nëpër territoret tona dhe ku gjenden ato sot, etj. Jo vetëm kaq, por në këtë fushë, si historian, ai është ndoshta i pari që studioi dhe përqasi origjinën ilire të shqiptarëve.<sup>19</sup>

\* \* \*

### **Marrëdhëniet e kolonelit Lik me Ali Pashën**

Padyshim, një nga personazhet më në zë, në hapësirat ballkanike, që ndikoi me praninë, rolin, fuqinë dhe marrëdhëniet e tij në faktorin evropian, për të bërë të njohur shumë ngjarje dhe personazhe të kohës, mes të cilëve edhe Kolonelin

<sup>18</sup> Po aty, Letër e Likut qendrës, Janinë më 22 Gusht 1805.

<sup>19</sup> W.M. Leake: “Travel in Northern Greece and...”, J. Rodwell, 1835, Vol I-II-III-IV, London.

Lik, ishte shqiptari më i dëgjuar i asaj epoke, Pashai i Pashallëkut të Janinës, Ali Pashë Tepelena.

Kur britanikët e parë zbritën në këto anë, fuqia ushtarake e tepelenasit, transformimet e mëdha ekonomike, sociale dhe zgjerimi i pushtetit të tij në një pjesë të madhe të territoreve të Ballkanit, e kishin kthyer këtë burrë në një faktor të rëndësishëm politik në këtë pjesë të Evropës. Për këto arsye, çdo fuqi evropiane, çdo lëvizje, projekt apo plan i tyre, përpara realizimit, duhet të merrte mirë në konsideratë faktorin Ali Pasha.

Të njëjtën gjë bënte edhe qeveria britanike, ndërsa dërgonte njeriun e saj, Kapitenin e ri W. M. Lik, si misionar ushtarak drejt territoreve të Ali Pashës. Po të vëresh porositë e dërguara në mënyrë periodike nga qeveria britanike për Likun dhe marrëdhëniet e tij me Ali Pashën, dallon shqetësimin e madh të tyre për të qenë sa më të kujdesshëm në kontaktet me këtë njeri, për t'u afruar dhe tërhequr hap pas hapi në një aleancë ushtarake, për të përballuar ndonjë agresion të mundshëm të forcave franceze, në brigjet e Ballkanit perëndimor.

Pikërisht këtij qëllimi i ka shërbyer tërë misioni i W. M. Likut, kontaktet, vizitat, bashkëbisedimet, sugjerimet apo edhe ndihmat ushtarake e politike të ofruara ndaj Pashait të Janinës.

Ardhjen e Kapitenit të ri, tepelensasi e ka pritur me maturi dhe me kujdes qëmtues. Zbritja e tij në brigjet shqiptare përkon me pushtimin francez të Italisë, të Shtatë Ishujve të Jonit si dhe me kërcënimin serioz për invadim të brigjeve të Pargës, Prevezës, Butrintit, Sarandës e Vlorës. Aliu e njihte fare mirë se cila qe fuqia e tij ushtarake dhe aq më pak ajo detare përpara fuqisë së Bonopartit, që gjer atëherë kishte pushtuar pothuaj gjithë Evropën. Në këto rrethana atij i duhej një aleat i jashtëm i fuqishëm, që të mund të përballonte rrezikun e një agresioni të mundshëm.

Fillimisht, përmes njerëzve të tij, pastaj edhe në kontakte direkte, Aliu ishte tepër i kujdesshëm dhe i matur në marrëdhëniet me britanikun. Siç del nga materiali i kohës ai synonte të mësonte qëllimet që ndiqte ardhja e tij dhe cilat qenë synimet e vërteta të qeverisë britanike.

Të interesuar për një bashkëpunim sa më të afërt, për interesa të caktuara politike, anglezët i kanë ofruar dhe plotësuar Ali Pashës një numër kërkesash për municion luftarak, mbështetje navale dhe informacione të karakterit subversiv, lidhur me komplete dhe plane që thurnin francezët me bejlerët dhe pashallarë shqiptarë, kundërshtarët e Ali Pashës, mbi qarkullimin dhe vendstrehimet e komitëve dhe hajdutëve të famshëm, përpjekje për asgjësimin fizik të tij nga ana e francezëve, etj.

Në informacionet e para, të Kapitenit Lik, të dërguara Londrës, për Ali Pashën, karakterin, fuqinë, synimet, interesat dhe prirjet e tij, gjejmë përcaktime e të dhëna mjaft interesante, të cilat padyshim janë frut i një pune dhe studimi të kujdesshëm, të vendosjes së një kontakti psikologjik të drejtpërdrejtë dhe jo pak realist. Në një prej tyre ai informon:

“... Ali Pasha ra shpejt në sy, - shkruhet në një nga këto raporte, - për shkak të shpirtit të tij ambicioz. Fati dhe dëshira e tij për pushtet e kanë ndihmuar gjithmonë atë. Këto dy prirje janë pasioni mbizotërues i mendjes së tij. Në fillim ai u punësua si Kapiten i rojeve të Kurt Pashës, por nuk qëndroi për shumë kohë në atë zonë periferike... dhe u kthye shpejt në Tepelenë, në vendin e tij të lindjes, një terren tepër malor dhe që banohet nga një popullsi më luftëdashësja ndër tërë shqiptarët myslimanë ...”<sup>20</sup>

“...Me vdekjen e Kurd Pashës, 11 vjet më parë, ai e zëvendësoi atë dhe mori në dorë komandimin e dervenëve dhe të vetë Trikallës. Që nga ajo kohë fuqia e tij ka ardhur duke u rritur...”

“...Ali Pasha tanimë e ka konsoliduar kaq shumë autoritetin e tij në drejtim të Veriut dhe të Lindjes, nëpërmjet komandimit të të gjithë derveneve, saqë mund të thuhet pa mëdyshje se ai është Zot i padiskutueshëm i të gjithë vendit që shtrihet nga Lebedea në Beoti, në një linjë që shtrihet drejt veriut gati gjer në Pella, pranë lumit Vardar, në Maqedoni dhe prej atje drejt Ohrit në Shqipëri...”<sup>21</sup>

Me një maturi të admirueshme, duket se Kapiteni Lik, ka aritur të kuptojë qartë edhe synimet e vërteta politike, që Ali Pasha bluante brenda heshtjes domethënëse të tij, apo që i fshehte nëpër rreshtat e pathëna të dialogjeve me britanikun e vëmendshëm.

“Më duket e tepërt të sqaroj atë ç’ka u tha në bisedë me Ali Pashën, pasi për mua duket qartë, që pozicioni i tij mbështet në interesat dhe synimet që ai ka. Në bisedën me mua ai nuk synoi asnjë nga Ishujt e tjerë të Jonit veç Santa Maurën....Dëshira e tij ishte që ishujt e tjerë t’i shikonte të kalonin në duart e një Fuqie, tek e cila ai nuk dyshon të ketë qëllime ambicioze për territoret e Pashallëkut.... Frika e synimeve të tilla e kanë mbajtur atë nën një mister dyshimi, që kur ishujt u pushtuan për herë të parë nga Franca, më 1790, si dhe frika e zbatimit të projekteve revolucionare të jakobinëve, ... apo intrigat e rusëve bazuar në paragjykimet fetare me grekët...”<sup>22</sup>

Megjithatë, duhet thënë se Ali Pasha duket që ka pasur një ndjesi besimi më të afërt për britanikët e pse jo personalisht tek Koloneli Lik, në raport me tërë misionarët e tjerë, të fuqive evropiane, me të cilët ai ishte kontaktuar për shumë kohë. Por, nuk përjashtojmë që sentimente të njëjta reciproke të ketë

<sup>20</sup> Arch. Hardfordshire – London F.O. 78/44, Janinë 30 Qershor 1804. f. 3-6.

<sup>21</sup> Po aty.

<sup>22</sup> Arch. Hardfordshire – London F.O.78/57, Letër e Likut dërguar G. Kaningut më 1807.f.1-2

pasur edhe koloneli i ri britanik për Ali Pashën. Në një numër letrash dhe korrespondence personale që ruhet në këtë arkiv, gjenden edhe mjaft letërkëmbime, të cilat flasin hapur për këto marrëdhënie të miqësisë dhe besimit të ndërsjelltë.

Padyshim, këto janë një pjesëz fare e vogël e informacioneve të përgatitura aso kohe nga Liku, për shtabet britanike të luftës. Brenda këtij materiali voluminoz arkivor ka një lëndë mjaft të pasur dhe me vlerë ushtarake të panjohur. Në to gjejmë potencialin numerik të fuqisë ushtarake të Ali Pashës, fortifikimet me rëndësi strategjike, llojin e armatimit të kësaj ushtrie, përgatitjen dhe disiplinën e saj, moralin dhe patriotizmin, këshilltarët e huaj ushtarakë, llojet e armëve xhenion, këmbësorinë, artilerinë, shkollën e përgatitjes ushtarake në Bunila, etj.

Brenda radhëve të këtij informacioni të bollshëm ka edhe një material tjetër të larmishëm dhe interesant për aspekte të tjera të jetës shqiptare si gjeografinë, historinë e shkuar dhe atë kontemporane, moralin, karakterin dhe zakonet e popullsisë në krahina të ndryshme të Shqipërisë. Brenda rreshtave të raporteve gjejmë gjithashtu personazhe të ndryshme historike, të njohur gjer më sot apo edhe emra individësh të panjohur që kanë luajtur një rol të caktuar apo kanë lënë gjurmë në historinë e atyre anëve.

### **Botime të tjera shkencore të panjohura të Likut**

Nga viti 1804 gjer në vitin 1809, me gjithë situatën e rënduar politike për Anglinë në territoret osmane, Koloneli realizoi, paralelisht me kryerjen e detyrës si ushtarak, një numër studimesh topografike dhe arkeologjike, duke arritur në konkluzione të mahnitshme, mjaft të sakta, mbështetur në njohuritë e tij të thella të autorëve antikë, burimet dhe dokumentet e lashtësisë që bënin fjalë për trojet ilire, helene dhe më gjerë. Atë kohë ai evidenton dhe lexon epigrafitë në terrenet dhe monumentet e antikitetit, nxjerr ato nga errësira dhe i bën ato të njohura për rrethet shkencore dhe publikun evropian.

Në një nga këto udhëtime, për kryerjen e misioneve ushtarake të ngarkuara, më 1806, arrestohet nga autoritetet osmane dhe dërgohet në burgun e Selanikut, nga ku arriti të shpëtojë për mrekulli gjatë transportit, me një galerë.

Mbas lirimit nga burgu, ai caktohet zyrtarisht nga qeveria britanike, si diplomat (konsull) pranë Pashallëkut të Janinës. Në këtë detyrë ai qëndroi gjer në vitin 1809. Me t'u kthyer në atdhe ju përvesh punës dhe botoi një numër artikujsh dhe shkrimesh me karakter historik, gjuhësor, gjeografik, etj.

Më 1815 u thirr përsëri nga qeveria britanike për t'u ngarkuar me një detyrë dhe mision të ri ushtarak, këtë herë si specialist artilerie dhe këshilltar pranë trupave të ushtrisë zvicerane të Arkidukës Johan, në Bernë, ku qëndroi gjer në vendosjen e paqes në Evropë. Me t'u kthyer në Angli, iu përvesh punës

shkencore, veprimtari të cilën e vazhdoi pa u lodhur gjer në fund të jetës së tij.

Në radhën e botimeve të tij renditen:

Më 1814; “Researches in Greece” – studime mbi gjuhën moderne greke

Më 1822; “Burckhards travels in Nubia, Siria and Arabia”

Më 1826; “An historical outline of the Greek Revolution”

Me 1829; “The Demi of Attica”

Më 1830; “Travels in Morea”, në tre volume

Më 1835; “Travel in Northen Greece” në katër volume.

Më 1841; “The topography of Athens”

Më 1855; “Nomizmatika Hellenistica”, Brenda koleksionit të pasur, të grumbulluar gjatë viteve që qëndroi në Shqipëri e Greqi, gjenden një numër mjaft i madh i monedhave të prera nga mbretëritë ilire.

Më 1859, pak javë përpara se të vdiste, ribotoi nën një rishqyrtim dhe trajtim të ri shumë çështje historike, topografike, nomizmatike të konstatimeve dhe gjetjeve të tij të mëparshme.

Mbas botimeve të tij të para dhe suksesit që ato gjetën në rrethet shkencore në Angli dhe jashtë saj, në vitin 1828, Koloneli Lik, u zgjodh “Anëtar Themelues i Shoqërisë Gjeografike të Berlinit”. Po atë vit, nderohet me titullin: “Anëtar Nderi i Institutit Mbretëror Francez”

Në vitin 1838, laureohet me titullin “Ambasador i Karl Wilkins”.

Vdes në vitin 1859 dhe varroset me nderime ne varrezat Kensal Green, ku prehet edhe sot.

**Irakli KOÇOLLARI**